ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër**: POLICIA E KOSOVËS**

Nr1 i prokurimit	**214-24-13303-1-1-1**
Nr i brendshëm	**214/24/178/111**

Sa i përket tenderit për: **"FURNIZIM ME RROBA CIVILE PËR ZYRTARET POLICOR".**

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Ukshin Kovaçica, nr 11
(Adresa)

Prishtinë ***10000***
(Vendi) *(Kodi postar)*

+38344877617
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Elbasan Morina
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

infokosova@piertechnical.hu
(Adresa elektronike)

11.04.2025
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

PIER TECHNICAL KFT
Branch in Kosovo
812019687
PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 18.02.2025 Data e hapjes së ofertave: 03.03.2025 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 27.03.2025 Kërkesa për rishqyrtim dt.01.04.2025 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:03.04.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 62 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së** **Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik** **Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Ne me dt. 27.03.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit**,** ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin si në vijim:

OE është i papërgjegjshëm për pikat ne vijim:

- Ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë po ashtu edhe tek aneksi 1 specifikat teknike te detyrueshme është kërkuar si atestet laboratorike duke përfshirë përbërjen e materialit, Duhet te kenë qëndrueshmëri ne ngjyrë te mos tjetërsohet, Materiali qe nuk rrudhet, Duhet te kenë qëndrueshmëri ne qepje.) ne ofertën tuaj keni dorëzuar atestet mirëpo nuk keni dorëzuar atestet për artikullin 1,2 dhe 4 për materialin qe nuk rrudhet.
- Mostrat e dorëzuara nga ana juaj shihet qe janë material qe rrudhet shih foto e mostrave te dorëzuara.

- Këmisha



- SETËR

- KAT

Arsyet e autoritetit kontraktues për eliminimin tonë janë të paqëndrueshme për faktet si në vijim:

Sa i përket arsyes se për artikullin 1, 2 dhe 4, nuk janë dorëzuar a-testet për materialin që nuk rrudhet, ju sqarojmë se mostrat e dorëzuara nga ana jonë janë prodhuar dhe testuar sipas specifikimeve teknike.
Gjatë ngarkimit të dokumenteve dhe dorëzimit të ofertës ka ndodhur një lëshim teknik nga ana jonë ku nuk janë bashkangjitur edhe testimet e fundit për anti-wrinkle apo për testimin e materialit që nuk rrudhet.

Mirëpo edhe përkundër këtij lëshimi teknik nga ana jonë autoriteti kontraktues konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 ka mundur të kërkoj sqarime shtesë në lidhje me mungesën e këtyre testeve, mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe përkundër faktit që ne kemi qenë OE i vetëm ofertues në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne nenin 59.2 specifikohet qartë si në vijim: *2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim* ***mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve****. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues*.

Sa për korrektësi dhe me qëllim që të vërtetojmë gjendjen faktike, që mostrat e dorëzuara nga ana jonë janë të testuara kundër rrudhjes **po ju bashkangjesim a testet e lëshuara nga laboratori i akredituar e të cilat a teste janë të lëshuara para datës së hapjes së ofertave.** Në këtë rast të njëjtat a-teste janë konform paragrafit 3 të nenit 72 të LPP-së, ku përcaktohet qartë *"3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive".*

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim më të njëjtat pasi që nuk na ka kërkuar sqarime në lidhje me mungesën e testimit për materialin që nuk rrudhet.

Sa për sqarim tuaj siç edhe e dini përveç këmishës dhe kravatës, të gjitha produktet tjera në përqindjen më të madhe kanë përmbajtje materiali leshin. Pasi që nga tenderi i kaluar AK-ja ka ndryshuar specifikat vetëm për pantollonat për zyrtarët/hetuesit policor, duke rritur % e materialit të leshit nga 70-75% në 90-97% lesh, ne kemi testuar dhe dorëzuar testin për anti-rrudhë. Nga një logjikë e thjeshtë do të duhej të kuptohej se nëse pantollonat me përmbajtje leshi 90-97 % janë anti-rrudhë e njëjta do të duhej të kuptohej edhe për setrën për zyrtarët/hetuesit policor dhe katin për zyrtarët policor pasi që të gjitha këto produkte kanë përmbajtje të njëjtë të materialit *(përkundrazi % e materialit të leshit është më e vogël dhe e polyesterit më e madhe tek mostrat e kontestuara nga AK)* dhe i vetmi dallim është tek pantollonat, ku AK-ja ka bërë ndryshimin e lartcekur.

Për ta bërë më të qartë konstatimin e lartcekur, ju sqarojmë se përveç materialit të leshit i cili hyn në kategorinë e materialeve natyrale, poliesteri është material sintetik që prodhohet në laborator dhe në përgjithësi të gjitha materialet sintetike si poliesteri, nyloni, elastani etj., janë materiale që kërkojnë më pak hekurosje për shkak të përbërjes së tyre kimike, pra të njëjtat në vetvete konsiderohen materiale anti-rrudhe pasi rrudhen më pak dhe kërkojnë më pak hekurosje **(shih elaborimin me poshte):**

THE COMMON TYPES OF SYNTHETIC FABRICS

1. POLYESTER

Polyester is the most used synthetic fibre, making up about 90% of all synthetic fibres produced worldwide. Features excellent wrinkle resistance and shape retention. Commonly used in clothing, home furnishings, and industrial applications. First developed in the 1940s, it is highly durable and made from petroleum.

Polyester fabrics have the following properties:

- Wrinkle-resistant, quick-drying and lightweight
- Provides high strength and durability
- Retains its shape well
- Resistant to most chemicals
- Low moisture absorbency

https://www.sahnifabrics.com/blogs/news/different-types-of-synthetic-fabrics?srsltid=AfmBOor3JjktZ5IP2TmUGhwAhm3fWxs8JjBRZu5tmXiyJ-A9uAlQofaD

Nga këto fakte, konstatohet se çdo rrobë e prodhuar e cila në përmbajtje ka material polyester konsiderohet si anti-rrudhe, në rastin tonë ju ritheksojmë se produktet si kati, setra dhe pantollonat kane të njëjtin material sipas dosjes së tenderit pra; material leshi dhe polyester por i vetmi dallim qëndron sepse tek pantollonat AK-ja nga hera e kaluar ka ndryshuar % e materialit te leshit nga 70-75% në 90-97% lesh dhe 25-30% në 3-10% polyester. Sigurisht që ne për pantollonat kemi bërë testim të veçantë pasi që AK-ja kishte ndryshuar % e materialit, në këtë rast logjikisht mund të kuptohet se nëse të gjitha produktet në fjalë kanë në përbërje të njëjtin material, gramazhe, ngjyrë etj,. por i vetmi dallim qëndron tek pantollonat dhe atë ne % e materialit të leshit, dhe përderisa pantollonat janë anti-rrudhë, atëherë e njëjta duhet të kuptohej edhe produktet tjera-mostrat e dorëzuara, pasi që materiali është i njëjtë.

Me kërkesë për rishqyrtim po i bashkangjesim raportet e testimeve për materialin që nuk rrudhet në gjuhën kineze dhe të njëjtat raporte të përkthyera i gjeni edhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht me këtë kërkesë për rishqyrtim për secilin nga raportet e testimit po i bashkangjesim edhe dëshmitë nga interneti të cilat ju shfaqen në momentin që bëhet skanimi i scan codit nga raportet e testimit ku figuron qartë që është bërë testimi i materialit dhe produkteve për anti-wrinkle. **(Të njëjtat i gjeni në faqet e fundit të secilit raport të testimit)**.

Sa për ilustrim, kur skanohet testi për anti-rudhë në platformën e laboratorit (të akredituar) shfaqen këto rezultate, ku qartazi shifet që materiali i përdorur për prodhimin e mostrave është trajtuar dhe testuar për anti-rudhë, për më shumë shih ilustrimin:



212220110005

China Accreditation International Mutual Recognition Testing CNAS L0568

Test report

№: 2024-08EC071038

Product Name: Suits + Fabrics

Rezultati online pas skanimit:

ort.cqjz.com.cn:5858

Dear customer: This is your second query of the 2024-08EC071038 inspection report. The results are as follows:

Report number: 2024-08EC071038
Sample name: suit + fabric
Inspection category: commissioned test
Commissioning unit: Chongqing Longcheng Buzun Clothing Co., Ltd.
Production unit: /
Trademark: /
Specification model: /
Batch date: /
Sample quantity: 3 pieces + 4 pieces
Sampling base: /
Inspection basis: GB/T 18863-2002 "Wrinkle-free textiles", GB/T 6152-1997 "Textiles - Test for color fastness - Color fastness to hot pressing", FZ/T 20021-2012 "Test method for dimensional change of fabrics after steaming", GB/T 21294-2014 "Test method for physical and chemical properties of clothing"
Inspection conclusion: For a summary of the test data, please see the next page.
Main inspector: Luo Juan
Issue date: 2024-07-30
Inspection department: Chongqing Metrology and Quality Inspection Institute

【Details】

Serial number	Inspection items	Single judgment
1	Easy-ironing performance (wash and dry 5 times)	
1.1	Appearance smoothness after washing and drying (grade)	
1.2	Seam appearance after washing and drying (grade)	

Gjithashtu sa për informimin tuaj, rezultatet normale të testimeve për anti-rrudhë janë nga 3.0-3.9 (shih foton e mëposhtme), ndërsa rezultatet tona të testimeve të cilat i gjeni në faqet e dyta të raporteve të cilat po i bashkangjesim edhe më poshtë janë 4-4.5, e që i bie se përveç që mostrat e dorëzuara i kemi testuar për anti-rrudhë njëkohësisht të njëjtat rezultate janë më të larta se sa testimet normale që zakonisht bëhet në industrinë e tekstilit përkatësisht rezultatet tona janë pothuajse në shkallën e fundit të rezultateve për anti-rrudhë. **(Bashkangjitur gjeni studimin AATCC TM124-2018t në lidhje me metodat e testimit dhe shkallët e testimit).**

AATCC TM124-2018t

Test Method for Smoothness Appearance of Fabrics after Home Laundering

Developed in 1967 by AATCC Committee RA61; revised 1969, 1975, 1982, 1989 (with title change), 1992, 1996, 2005, 2006, 2009 (with title change), 2010, 2011, 2014, January 2018 (with title change), November 2018; editorially revised 1974, 1983, 1985, 1988, 1991, 1997, 2004, 2008, 2012, June 2018; reaffirmed 1973; editorially revised and reaffirmed 1978, 1984, 2001. Technically equivalent to ISO 7768.

Foreword

This test method and its accompanying three-dimensional smoothness appearance replica set were developed for evaluation of woven fabrics with a durable-press finish. It is common industry practice to use the method and scales for evaluation of other textile materials although some specimens may have different appearance characteristics due to different fabric constructions.

Standard laundering procedures remain consistent to allow valid comparison of results. Standard procedures represent, but may not exactly replicate, current consumer practices, which vary over time and among households. Alternate laundering procedures and machine parameters may be found in AATCC LP1, Laboratory Procedure for Home Laundering: Machine Washing, (see 12.3) and ISO 6330, Textiles — Domestic washing and drying procedures for textile testing (see 12.8).

1. Purpose and Scope

1.1 This test method is intended to determine the smoothness appearance of fabrics after being subjected to home

AATCC Three-Dimensional Smoothness Replicas. Results are reported as a smoothness appearance (SA) grade of 1 to 5, with 1 representing the least smoothness and 5 representing the most smoothness (no wrinkles).

3. Terminology

3.1 **ballast,** n.—*in procedures for processing or testing of textiles*, material that is used to bring the total weight or volume of the textiles to an amount specified in the procedure.

3.2 **durable press,** adj.—having the ability to retain substantially the initial shape, flat seams, pressed-in creases and unwrinkled appearance during use and after laundering or drycleaning.

3.3 **grade**, n.—the number assigned to a test specimen resulting from comparison to a scale.

3.4 **laundering,** n.—*of textile materials*, a process intended to remove soils and/or stains by treatment (washing) with an aqueous detergent solution and normally including rinsing, extracting and drying.

3.5 **laundering creases,** n.—sharp folds or lines running in any direction in a washed or dried specimen.

NOTE: Laundering creases are an unintended result of restricted movement of specimens in a washer or the dryer.

3.6 **smoothness appearance,** n.—*in fabrics*, the visual impression of planarity of a specimen quantified by comparison with a set of reference standards.

4. Safety Precautions

NOTE: These safety precautions are for information purposes only. The precautions are ancillary to the testing proce-

4.4 Manufacturer's safety recommendations should be followed when operating laboratory testing equipment.

5. Uses and Limitations

5.1 This test method is designed to be used only for evaluating the appearance of washable fabrics after home laundering.

5.2 In general, it is preferable to conduct the test under relatively severe laundering conditions. It is recognized that special cycles or features are available on current washing machines and dryers to achieve improved performance on certain items; e.g., gentle cycles with reduced agitation to protect delicately constructed items, and durable press cycles, with cool-down or cold rinses and reduced spin speeds, to minimize wrinkling.

5.3 Prints and patterns may mask the mussiness present in fabrics. The evaluation process is, however, based on the visual appearance of specimens including such effects.

5.4 The Smoothness Appearance Replicas were cast from woven fabrics. It is understood that the replicas do not duplicate other fabric possibilities (knits, nonwovens). The replicas are to be used as guides that represent various levels of fabric smoothness.

5.5 Small specimen sizes will occasionally result in wrinkles or creases. These may not be characteristic of actual performance, in use.5.6 The interlaboratory reproducibility of the results of this test method depends upon mutual agreement by users of the method on the washing and drying conditions as outlined in Tables I-IV.

What is a Durable Press Rating?

Fabrics with durable press finishes are often rated based on **Wrinkle-Free Performance Grades:**

Durable Press (DP) Rating	Performance
DP 5.0	Completely smooth, no wrinkles. (Rarely achieved)
DP 4.0 – 4.5	Very good wrinkle resistance, minimal ironing needed.
DP 3.5 – 3.9	Moderate wrinkle resistance, some creases may form.
DP 3.0 – 3.4	Acceptable, but wrinkles appear after wear/wash.
DP < 3.0	Poor wrinkle resistance, requires ironing.

Garments with a **DP rating of 3.5 or higher** are often marketed as **"Wrinkle-Free" or "Non-Iron"** clothing.

Kati dhe Setra:

Chongqing Metrology and Quality Inspection Institute

Test report

Report number : 2024-08EC071038 Page 2 of 3

Serial number	Test items	Test results
1	Easy-ironing performance (wash and dry 5 times)	4
1.1	Appearance smoothness after washing and drying (class)	4

Këmisha:

Chongqing Metrology and Quality Inspection Institute

Test report

Report number : 2024-08EC071037 Page 2 of 3

Serial number	Test items	Test results
1	Easy-ironing performance (wash and dry 5 times)	
1.1	Appearance smoothness after washing and drying (class)	4

Kravata:

Chongqing Metrology and Quality Inspection Institute

Test report

Report number : 2024-08EC071034 Page 2 of 3

Serial number	Test items	Test results
1	Easy-ironing performance (wash and dry 5 times)	4.5
1.1	Appearance smoothness after washing and drying (class)	4.5

Dëshmitë të cilat po i bashkangjesim dëshmojnë qartë se të gjitha mostrat e dorëzuara tek AK-ja, janë prodhuar konform kërkesës se dosjes së tenderit dhe se materiali për prodhimin e mostrave është trajtuar për anti-rrudhë dhe këtë e dëshmojnë testet e laboratorit i cili ka konfirmuar me shkrim tek AK-ja vërtetësinë e testeve dhe po të njëjtat teste mund të skanohen dhe vërtetohen online nga AK, siq e shpjeguam me lart. Në një skanim të thjeshtë mund të shihet qartë e dokumentuar se materiali i përdorur për prodhimin e mostrave është anti-rrudhë.

Kur analizohen raportet e testimit të cilat po i bashkangjesim me kërkesë për rishqyrtim shihet qartë se mostrat e dorëzuara nga ana jonë, janë testuar sipas të gjitha specifikave të përcaktuara nga autoriteti kontraktues dhe përderisa të njëjtat raporte të testimit janë dokumente ekzistenca e të cilave vërtetohet që është para datës së hapjes, atëherë kuptohet qartë se ne si OE i vetëm në këtë aktivitet jemi të përgjegjshëm dhe si i tillë duhet të konsiderohemi edhe nga ana e AK-së.

(Shih komunikimin dhe konfirmimin nga laboratori ku edhe konfirmohet se testet janë bërë në Korrik të vitit 2024 dhe po të njëjtin konfirmim e ka pranuar edhe Policia e Kosovës).

Re:lab test verification

技术质量部 <jz@cqjz.com.cn>
To e.morina

Reply Reply All Forward
Mon 3/31/2025 4:14 AM

Dear sir:
we have checked the three reports you asked in the em.These reports have been issued by us in July, 2024. But we issued in Chinese not in English. we also have given the feedback to Kosova police with the original reports under the authorization of our client last year.
If there is any thing we can help further more, We would like to offer the assist as much as we can.
Best wishes!

CHONGQING ACADEMY OF METROLOGY AND QUALITY INSPECTION
2025-03-31

---- 原邮件信息 ----
发件人:<e.morina@piertechnical.hu>
收件人: <jz@cqjz.com.cn>:
发送时间:2025-03-28 18:22:13
主题:lab test verification

Sa i përket fotografive të bashkangjitura në vendimin e autoritetit kontraktues, përmes të cilave AK-ja është munduar të konstatoj se mostrat e dorëzuara nuk janë prodhuar me material që nuk rrudhet, ju sqarojmë se në momentin që janë bërë fotografitë shihet qartë se mostrat nuk janë të shtrira siç duhet.

Gjithashtu ju sqarojmë se nuk ekziston asnjë material në industrinë e tekstilit i cili nuk rrudhet asnjëherë. Në momentin që në specifikime teknike kërkohet një material "anti-rrudhë", ky fakt nuk do të thotë që i njëjti nuk rrudhet fare, por se rrudhat shfaqen më pak dhe janë shumë më të lehta për t'u hequr.

Në këtë rast mostrat e dorëzuara nga ana jonë kanë ndenjur të palosura për kohë të gjatë, andaj është e pamundur që një produkt i cili për një kohë të gjatë është i palosur të mos rrudhet.

Nëse bëhet një kërkim i thjeshtë në internet mund të vërtetohet fakti se materialet që janë “anti-rrudhje”, nuk janë materiale të cilat nuk mund të rrudhen asnjëherë, por janë materiali që nuk rrudhen lehtë dhe largimi i rrudhave është shumë më i lehtë se tek materialet tjera. Për konstatimin e lartcekur ne po ju bashkangjesim edhe disa dëshmi, pikërisht për materialet e kërkuara në specifikime teknike, të cilat edhe AK-ja mund ti vërtetoj shumë lehtë, përmes të cilave vërtetohen konstatimet tona të lartcekura. **(Bashkangjitur gjeni dëshmitë e lartcekura).**

Për informimin tuaj, si prodhues me mbi 30 vite përvojë në fushën e tekstilit, konfirmojmë se të gjitha mostrat e dorëzuar për këtë aktivitet janë prodhuar sipas specifikave dhe materiali i përdorur është trajtuar/testuar për anti-rudhë për të cilën ofrojmë dëshmitë relevante e për të cilat kërkojmë që edhe ju si AK të bëj vërtetësinë e tyre.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se ne si OE i përgjegjshëm, jemi eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pa ndonjë bazë ligjore, prandaj kërkojmë nga ana e AK-së që ti analizoj në detaje të gjitha dëshmitë dhe pretendimet tona ankimore dhe pastaj të nxjerr një vendim konkret në lidhje me kërkesën për rishqyrtim.

Gjithashtu ne e kemi cekur se nëse eventualisht AK-ja ka ende dyshime në lidhje me materialet e prezantuara nga ana jonë, ne e inkurajojmë autoritetin kontraktues dhe tani edhe OSHP që të bëj edhe testimin e mostrave të dorëzuara, me qëllim që të vërtetohet fakti që pretendimet tona ankimore janë të bazuara dhe se ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Nëse eventualisht AK-ja, eksperti shqyrtues apo edhe paneli shqyrtues i OSHP-së e sheh të arsyeshme të kërkoj sqarime shtesë apo nëse ekziston ndonjë paqartësi në lidhje me pretendimet tona ankimore, ne jemi të gatshëm që të japim përgjigjje për të gjitha paqartësitë e AK-së.

Ne me dt.03.04.2025 kemi pranuar vendimin e autoritetit kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk janë dhënë fakte konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues arsyetimin e vetëm që e ka dhënë në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është se raportet e testimeve të cilat i kemi bashkangjitur me kërkesë për rishqyrtim, nuk mund të merren parasysh sepse janë dokumente të reja dhe të njëjtat i ka cilësuar si ndryshim material, ndërsa në arsyetimet tjera vetëm ka bërë përshkrim të dispozitave ligjore, se kinse të njëjtat nuk janë shkelur nga AK-ja.

Në lidhje me arsyetimin e autoritetit kontraktues se raportet e testimeve për anti-rrudhë të cilat e mbajnë datën para datës së hapjes, janë teste të reja dhe janë ndryshim material, ju sqarojmë se një arsyetim i tillë është krejtësisht i paqëndrueshëm dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore.
Raportet e testimeve të cilat i kemi bashkangjitur me kërkesë për rishqyrtim dhe tani me ankesë është dashur të merren parasysh nga ana e AK-së sepse siç edhe e cekëm të njëjtat janë raporte të cilat tregojnë se produktet me të cilat kemi ofertuar janë testuar për anti-rrudhë dhe të njëjtat kanë datë para datës se hapjes së ofertave. Faktin se raportet janë origjinale e ka vërtetuar edhe vet laboratori përmes deklaratës së tyre, të cilën e kemi bashkangjitur edhe në kërkesë për rishqyrtim, mirëpo që AK-ja nuk e ka marr parasysh fare deklaratën e bashkangjitur nga ana jonë. Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim e cek se raportet e prezantuara nga ana jonë të cilat janë raporte të lëshuara para datës së hapjes së ofertave, nuk e lejon ligji të pranohen, mirëpo nuk e ka cekur fare se cila dispozitë e ndalon një gjë të tillë.

Përderisa AK-ja nuk i është referuar një dispozite konkrete që e ndalon që raportet tona të mos pranohen, atëherë kuptohet qartë se arsyetimi i të njëjtës është tendencioz kundrejt kompanisë tonë, si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit. Sa i përket ligjit, ju sqarojmë se ligji e sqaron qartë përkatësisht dispozita e nenit 72 të LPP-së, përkatësisht paragrafi 3 ku përcaktohet qartë *"3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit* ***do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive****".*
Pra përderisa raportet e dorëzuara me kërkesë për rishqyrtim e mbajnë datën shumë më herët se data e hapjes së ofertave, atëherë në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të thuhet se

këto dokumente nuk duhet të merren parasysh. Kjo arsye nga AK-ja është cekur vetëm me qëllim që ne si OE i përgjegjshëm dhe OE i vetëm në këtë aktivitet të prokurimit, të mos rekomandohemi për kontratë dhe të mos shpallemi fitues i këtij tenderi.

Edhe një herë po e sqarojmë se raportet e testimit për anti-rrudhë nuk mund të cilësohen në asnjë mënyrë si dokumente të reja, sepse sipas dispozitave të LPP-së raportet tona janë raporte ekzistenca e të cilave mund të vërtetohet që kanë ekzistuar para datës së hapjes së tenderëve. Pra me një fjalë ne nuk kemi prezantuar raporte të reja pas datës së hapjes së ofertave, mirëpo kemi prezantuar raporte shtesë për testim të produkteve, vetëm për anti-rrudhë, të cilat kanë të bëjnë me produktet e njëjta për të cilat janë dorëzuar raportet e testimeve me rastin e ofertimit, pra raportet janë dokumente shtesë.

Ne kërkojmë nga ana e ekspertit shqyrtues dhe nga ana e panelit shqyrtues të OSHP-së që ti analizoj në detaje të gjitha dokumentet e prezantuara nga ana jonë me rastin e ofertimit dhe dokumentet të cilat po i bashkangjesim në ankesë, me qëllim që të vërtetohet gjendja faktike, pasi që në këtë rast po eliminohemi me arsye krejtësisht të paqëndrueshme.

Nëse eventualisht faktet, dëshmitë dhe pretendimet tona ankimore nuk merren parasysh pa dashur që një gjë e tillë të cilësohet si kërcënim, ne jemi të detyruar të vazhdojmë me ankimime edhe në instancat tjera më të larta, për të kërkuar të drejtën tonë, sepse po eliminohemi me arsye të cilat janë në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, e po ashtu nuk është respektuar fare neni 60 i LPP-së.

Pra duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente,* ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos na rekomanduar për kontratë edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe kemi ofertuar me çmim më të ulët.

Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

APROVOHET, e bazuar ankesa e OE **"PI ER TECHNICAL Kft Branch in Kosovo"**.

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim dhe ankesë në vlerë prej 10,000.00 euro.

v10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*